



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:241316
Datë: 12.03.2024
Numri i dokumentit: 05437106

Ac.nr.2345/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, kolegji në përbërje nga gjyqtari Valon Totaj – kryetar i kolegjit dhe gjyqtarëve Bujar Muzaqi dhe Lumni Sallauka – anëtar të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Blerina Sallauka, në çështjen juridike kontestimore të paditëses KEK – Koorporata Energjetike e Kosovës, të cilën e përfaqëson i autorizuari i saj I.R., kundër të paditurit H.I. nga P..., të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av.M.N. nga P..., për shkak të kompensimit të dëmit material, duke vendosur sipas ankesës së paditëses, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.3296/2014, të datës 08.10.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 08.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditëses KEK – Koorporata Energjetike e Kosovës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.3296/2014, i datës 08.10.2020, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me pikën I të aktgjykimit të ankimuar C.nr.3296/2014, të datës 08.10.2020, e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses KEK – Koorporata Energjetike e Kosovës, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri H.I. nga Prishtina, që paditëses në emër të kompensimit të dëmit material t’ia paguajë shumën prej 4,079.12 euro dhe atë me kamatë nga data 08.12.2014, dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 25.00 euro. Me pikën II të dispozitivit e ka detyruar paditësen që të paditurit H.I. nga Prishtina t’ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej 374.00 euro në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi paditësja në afat ligjor ka paraqitur ankesë duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e paditëses dhe aktvendimi i atakuar të ndryshohet në mënyrë që kërkesëpadija e paditëses të aprovohet si e bazuar.

I padituri nuk ka paraqitur përgjigje në ankesën e paditëses.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- ankesa e paditëses është **e pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me datën 03.12.2014, paditësja KEK – Koorporata Energjetike e Kosovës në gjykatën e shkallës së parë ka parashtruar padi kundër të paditurit H.I. nga P..., për shkak të kompensimit të dëmit material, më gjerësisht sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimin e të gjitha shkresave të lëndëve ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.3296/2014, të datës 08.10.2020, me të cilin e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses KEK – Koorporata Energjetike e Kosovës, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar. Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se dëmi i pretenduar nga pala paditëse është shkaktuar prej datës së pavërtetuar deri në datën 23.10.2008, për të cilin kërkohet kompensim, ku pretendimi i paditëses është që i padituri me qëllim që ti sjellë vetes pasuri të kundërligjshme, e ka shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar energjinë elektrike. Padija në gjykatë është dorëzuar me datën 03.12.2014, përkatësisht pas 6 viteve nga dita kur është krijuar dëmi, më saktësisht 1 muaj e gjysmë pas kalimit të afatit ligjor. Më tutje gjykata ka theksuar se nga aktvendimi penal P.nr.816/09, i datës 19.11.2014, i nxjerrë nga Gjykata Themelore në Prishtinë, ka hedhur propozim akuzën e Prokurorisë Publike Komunale në Prishtinë dhe ka pushuar procedurën penale kundër H.I., për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale. Si rezultat i parashkrimit të veprave penale, sipas dispozitave të nenit 377 të LMD është parashkruar edhe e drejta për kompensimin e dëmit. Lidhur me bazën juridike të kërkesëpadiisë gjykata i është referuar neni 376 paragrafi 1 dhe 2, neni 377 paragrafi 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD).

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore, pasi që dispozitivi i aktgjykimin është i kuptueshëm. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore duke arsyetuar të gjitha faktet vendimtare të cilat kanë ndikuar që e njëjta të vendosë si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar, të cilat arsye janë të pranueshme edhe për gjykatën e shkallës së dytë. Po ashtu sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në mes të arsyeve të paraqitura nuk ekzistojnë kundërthënie, në ndërkohë që kundërthënie nuk ka as në mes të dispozitivit dhe arsyetimit të aktgjykimin.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë për pathemelësinë e kërkesëpadisë së paditëses, është i drejtë dhe i argumentuar. Mbi këtë gjendje faktike të vërtetuar, gjykata ankimore e pranon në tërësi përfundimin e gjykatës së shkallës së parë për zbatimin e rregullt dhe të drejtë të dispozitave materiale - juridike nga edhe ka rrjedhur se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar.

Me nenin 262 të LMD parashihet se *“kreditori në raportin e obliguar është autorizuar që prej debitorit të kërkojë mbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij”*. Gjithashtu me nenin 377 të LMD përcaktohet se *“Kur dëmi është shkaktuar nga vepra penale dhe për ndjekjen penale është parashtruar një afat më i gjatë parashkrimi, kërkesa për shpërblimin e dëmit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale”*. Mbi bazën e kësaj gjendje faktike të vërtetuar dhe në kuptim të dispozitave ligjore të lartcekura rezulton se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses për borxhin e kërkuar për periudhën deri me datën 23.10.2008, në shumën prej 4.079,12 euro, për shkak të parashkrimit të kërkesës, pasi që është provuar se paditësja padinë e saj pranë gjykatës së shkallës së parë e ka parashtruar me datën 08.12.2014, në ndërkohë që energjia e shpenzuar elektrike i takon periudhës para muajit tetor të vitit 2008. Në rastin konkret kërkesëpadia e paditëses është parashkruar ngase dëmi është shkaktuar me datë 23.10.2008, ndërsa padia për kompensim dëmi në gjykatë është dorëzuar me datë 08.12.2014, përkatësisht pasi kanë kaluar 6 vite. Gjithashtu sipas aktvendimit penal P.nr.816/09, të datës 19.11.2014, është hedhur edhe propozim akuza dhe është pushuar procedura penale ndaj këtu të paditurit për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale, që ka qenë afati 6 vjeçar, e që në rastin konkret është parashkruar.

Andaj nga arsyet e cekura si më lartë, Gjykata e Apelit gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.2345/2021, me datën 08.03.2024

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari
Valon Totaj